



**UDHËZUES DIDAKTIK**

**“Bachelor” në “Psikologji”**

2019-2020-

**DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË**

*Axhenda e studentit:*

*Emër* \_\_\_\_\_

*Mbiemër* \_\_\_\_\_

*Libreza e studentit* \_\_\_\_\_

*Karta* \_\_\_\_\_

*Karta e bibliotekës* \_\_\_\_\_

**PUNOI DHE REDAKTOI:**

Dr. Edo Sherifi,

Msc. Klevisa Muça



## **FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE SHOQËRORE**

*Ky publikim është një instrument i vyer për të gjithë studentët e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të Kolegjit Universitar “Wisdom”, këtu do gjeni informacionet e nevojshme për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”*

*Duke analizuar planet e studimeve ju jepet mundësia, të përzgjidhni programet didaktike që ju përshtaten më shumë, me qëllim përvetësimin e njohurive të përgjithshme dhe atyre specifike që një të riu i interesojnë sot.*

*Fakulteti jonë mundëson disa disiplina dhe aktivitete, ku përfshihen laboratore, praktika; etj, që ju lejojnë të përvetësoni një formim profesional dhe fleksibël në mënyrë që të integrohëni me efikasitet në tregun e punës.*

*Jemi një fakultet që jetojmë të tashmen por që jemi të pasuruar dhe me të shkuarën, kjo për hir të dinamizmit dhe cilësisë të profesoratit dhe kërkuesve shkencorë, si dhe për figurat e shquara që kanë themeluar Fakultetin (mes të cilëve mund të përmendim, Paolo Foresti, Shefqet Muci etj..)*

*Kjo axhendë do t’ju ndihmojë të orientoheni në Fakultetin tonë!*



Programi “Bachelor” në “Psikologji” është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008 Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore ka si qëllim aktivizimin e subjekteve akademike dhe specialistëve nga më të njohurit për realizimin e një formimi modern në fushën e psikologjisë, në përputhje me standardet evropiane dhe përvojat e vendit.Mësimdhënia reflekton standarte perëndimore dhe pedagogët tanë janë konkurues në tregun akademik shqiptar.

## *Orientimi!*

*Ditët e  
orientimit*

*Universiteti  
me dyer të  
hapura*

*Takime me  
student*

*Guida e  
studentit*



Objektivat e vitit    Projektet

---

---

---

---

Si të realizoj objektivat ?

✓ \_\_\_\_\_

✓ \_\_\_\_\_



Objektivat financiare



Të lexoj ?

1

2

3

4



Skadencat didaktike



---

---

---

---

V/A 2019-2020

V

**KOLEGJI  
UNIVERSITAR  
WISDOM**

**PJESA I**  
INFORMACION I PËRGJITHSHËM

## ORGANET QË QEVERISIN FAKULTETIN

---

### Dekani

Prof.As oc. Dr. Erika MELONASHI

### Përgjegjësi i Departamentit Psikologjisë

Dr. Edo SHERIFI

### Përgjegjësi i Departamentit Ekonomisë

Dr. Ludmilla SHKURTI

### Përgjegjësi i njësisë së kërkimit shkencorë dhe marëdhënieve me jashtë.

Dr. Valbona SOFTA

Konsutohu me sitin e  
Fakultetit !  
[www.wisdom.edu.al](http://www.wisdom.edu.al)

Për më shumë  
informacion, drejtohu  
në sekretarinë  
mësimore!

  
Kolegji Universitar  
"Wisdom" - Faqja Zyrtë

## SEKRETARIA MËSIMORE

---

**Adresa:** Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë  
**Tel:** 04 2200063  
**Cel:** 0676022736  
**e-mail** [www.wisdom.edu.al](http://www.wisdom.edu.al)  
**Orari** Nga e hëna në të premte 09:00-20:00  
**Përgjegjëse e sekretarisë:** Anjeza Osmani

*Sekretaria mësimore e Kolegjit Universitar “Wisdom” realizon disa shërbime që vijnë në ndihmë të studentit, si për shembull: regjistrimin dhe matrikullimin e studentit, sistemimin e mbajtjen sekret të të dhënave të tyre. Sekretaria mësimore shpall orarin e mësimëve, praktikave, konsultimeve, provimeve duke ndjekur në vijshmëri edhe zbatimin e tyre.*

## SALLAT E LEKSIONEVE

---

*Godina kryesore tek (A) Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë.*

- kati i tretë , sallat 5,6, 7 (për ciklin e parë të studimeve )*
- kati i tretë, sallat 5,6 ( për ciklin e dytë të studimeve)*

## ZYRAT E PROFESORËVE

---

*Godina sekondare (B) tek Rruga “Medar Shtylla”, Komuna e Parisit, Tiranë.*

*Dekani zyra nr 3*

*Përgjegjësi i Departamentit*

*Psikologjisë zyra nr 4*

*Përgjegjësi i Departamentit Ekonomisë zyra nr 9*

*Përgjegjësi i njesisë zyra nr 2*

*së kerkimt shkencorë dhe*

*marëdhënieve me jashtë.*

**Orari i takimeve me profesorët**  
09:00-  
15:00



## BIBLIOTEKA

Shërbimi i bibliotekës ju mundëson një mjedis dhe ambient studimi, materiale dhe literaturë që u vijnë në ndihmë studentëve. Kjo bibliotekë ndodhet në katin e dytë të universitetit. Në të mund të gjendet çdo material që është i nevojshëm për studentët dhe stafin.

Biblioteka zotëron materiale të llojeve të ndryshme, siç janë libra, gazeta, revista, shkrime, botime. Gjithashtu u mundëson përdorimin e librave elektronikë, si dhe përpilim të dhënash të ndryshme.

Të gjithë anëtarët e stafit të bibliotekës mund t'ju vijnë në ndihmë për çdo kërkesë që ka lidhje me materialet që kërkoni. Biblioteka qëndron e hapur dhe e disponueshme çdo ditë nga ora 8:30 deri në orën 16:30.

## BIBLIOTEKA TË TJERA

*Bibliotekën Nr.4 të Njësisë Bashkiake Nr.9*

Adresa: Rruga Mine Peza

Në total kjo bibliotekë disponon afërsisht 16,000 copë libra.

Kjo bibliotekë ka gjithsej 8 vende studimi.

*Biblioteka e Akademisë së Shkencave*

Adresa: Sheshi Fan Noli, ngjitur me Kuvendin.

Biblioteka e Akademisë së Shkencave ka një trashëgimi rreth 65 000 vëllimesh periodike, të cilët mbulojnë të gjitha subjektet e kërkimit shkencor.

Kontakt: Tel :04 259 658

*Biblioteka Kombëtare*

Adresa : Sheshi Skënderbej, pranë Pallatit të Kulturës  
(Pallati i Kulturës)

Salla Shkencore;

Salla e Periodikut;

Salla "Paolo Petta";

Këndi Amerikan.

(Rruga Xh. Ë. Bush)

Salla Gjermane

Salla Shkencore

Kontakt: Tel :04 223 843 / 269 954 / 247 482 / 269

955 Tel/Fax : 04 257 670

*Biblioteka e Universitetit të Arteve*

Biblioteka e Universitetit të Arteve është biblioteka më e madhe dhe më e vjetra e artit në Shqipëri.

Fondi i Bibliotekës së Universitetit të Arteve përmban rreth 35,000 vëllime. Pjesa më e madhe e fondit është unikalë.

**Kontakt :**

Tel/Fax: +355 4 2 255 721

## KURSET - FILLIMI DHE MBARIMI

KURSET - FILLIMI DHE MBARIMI	
Semestri 2	<input type="checkbox"/> 14 tetor fillimi i vitit akademik 2019-2020
	<input type="checkbox"/> 7 shkurt mbarimi i semestrit të parë
	<input type="checkbox"/> 14-17 tetor java e orientimit dhe zgjedhja e lëndëve me zgjedhje.
	<input type="checkbox"/> 10 shkurt-28 shkurt sezoni i provimeve dimërore
Semestri 1	<input type="checkbox"/> 2 mars fillimi i semestrit të dytë
	<input type="checkbox"/> 12 qershor mbarimi i semestrit të dytë
	<input type="checkbox"/> 25-29 maj minisezoni i provimeve të mbartura
	<input type="checkbox"/> 15 qershor-10 korrik sezoni i provimeve verë
	<input type="checkbox"/> 29-30 qershor / mbrojtja e praktikave
	<input type="checkbox"/> 8/9/10 korrik ceremonia e diplomimit
	<input type="checkbox"/> 1-4 shtator regjistrimi për sezonin e provimeve
	<input type="checkbox"/> 7-20 shtator sezoni i provimeve vjeshtë
	<input type="checkbox"/> 21 shtator dorëzimi i diplomave për sezonin e vjeshtës
	<input type="checkbox"/> 24-25 shtator diplomimi

# Orari

Lënda	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____

Semesti **1**

**Shënim:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

# Orari


Lënda	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____
	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____	Ora _____ salla _____

**Shënim:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Semesti **2**

# PJESA II

INFORMACION  
MBI PROGRAMIN E STUDIMEVE BACHELOR në  
“PSIKOLOGJI”



## “Bachelor ” në “Psikologji”

Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë. Ai ofron një program të plotë studimesh universitare, që shtrihen në tre vite akademike në fushën e psikologjisë. Fakulteti synon të ruajë dhe forcojë imazhin aktual si një institucion i besueshëm dhe serioz, i cili përgatit studentë cilësorë, duke i mundësuar të jenë konkurrues në tregun e punës. Vizioni dhe misioni i Fakultetit realizohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet zhvillimit efektiv dhe efikas të programeve të studimit në nivel bachelor dhe në nivel master.

Programi i studimit në degën e Psikologjisë mundëson formimin akademik si specialistë të psikologjisë dhe si qytetarë aktivë të një shoqërie demokratike. Programi përgatit specialistë me koncepte psikologjike dhe aftësi e shprehë metodologjike për studim kërkimor shkencor, duke i aftësuar në zbatimin praktik të njohurive në fushën e psikologjisë. Programi është unik, pasi studentët përfitojnë një bazë solide të parimeve të psikologjisë përkrah aftësive këshilluese e psikoterapeutike, për të punuar me target grupe të gjera popullate klinike me çrregullime emocionale e psikologjike.

---

---

## NJOHURITË DHE KOMPETENCAT E STUDENTËVE NË PËRFUNDIM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

*Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” gjithashtu u ofron studentëve dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme për një punë të thelluar kërkimore e aplikative, të kualifikuar në trajtimin e zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve të ndërlikuara të jetës reale të adoleshentëve dhe të rinjve. Me njohuritë e përvetësuar studentët arrijnë të njohin mirë teoritë dhe terapitë psikologjike të kohës, veçanërisht drejtimin e psikologjisë dinamike dhe klinike, duke u thelluar në gërshetimin e kulturës profesionale të psikoterapisë individuale me psikoterapinë e grupit etj*

---



---

### MUNDËSITË PËR PUNËSIM

- ★ Në sistemin arsimor si :
  - Psikologë në arsimin parashkollor,
  - Psikolge në çerdhe dhe kopshte;
  - Psikologe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; në arsimin e lartë,
- ★ Si këshillues në institucionet e arsimit të lartë;
- ★ Trajnues për psikologët
- ★ Psikologë edukimi duke bashkëpunuar si ekspertë në politikat arsimore, në hartimin dhe përgatitjen e kurrikulave, të teksteve shkollore,

- ✦ Psikologë në institutet arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në përgjithësi në të gjitha strukturat e sistemit arsimor ku ndihet nevoja e shërbimeve të psikologut.
  - ✦ Në sistemin e shëndetësisë: si psikologë në spitale dhe maternitete; në spitalet psikiatrike dhe qendrat e shëndetit mendor;
-



<b>A - LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË)</b>				15-20%
1	I	I/II	T1	Biologjia dhe Proceset Psikofiziologjike (Moduli A dhe Moduli B)
2	II	I/II		Metodat Kërkimore dhe Analiza Cilësore dhe Sasiore (Moduli A dhe Moduli B)
3	I	I		Shkrim Akademik
<b>B - LËNDË TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT</b>				50 - 55%
1	I	I/II	T2	Hyrje në Psikologji ( Moduli A dhe Moduli B)
2	I	I/II		Psikologji Zhvillimi (Moduli A dhe Moduli B)
3	II	II		Psikologji e Punës dhe e Organizimit
4	II	I/II		Hyrje në Psikopatologji dhe Psikodiagnostikim (Moduli A dhe Moduli B)
5	III	I/II		Bazat e Këshillimit dhe Psikologjia Klinike (Moduli A dhe Moduli B)
6	III	I/II		Teoritë dhe Terapitë e Këshillimit në Grup (Moduli A dhe Moduli B)
7	II	II		Psikologji Personaliteti
8	III	II		Psikologji Konjitive
9	I	II		Psikologji Sociale
10	II	I		Psikologji Edukimi dhe Shkollore
<b>C - LËNDË NDËRDISIPLINORE /INTEGRUESE, nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje</b>				
1	III	I/II	T1/T2	Psikologji Testimi dhe Vlerësimi në Grup (Moduli A dhe Moduli B)
-	II	-		Psikologji Ligjore
2	II	I		Psikologji Emocioni
-	II	-		Teoritë Psikodinamike
3	II	II		Çështje të Etikës
4	I	II		Histori e Psikologjisë
5	I	I		Hyrje në Sociologji
-	-	-		Komunikim Ndërkulturor
-	-	-		Diferenca gjinore
<b>D – VEPRIMTARI PLOTËSUESE</b>				10- 15%
1	I	I/II	T3	Gjuhë e Huaj- Anglisht
2	II	I/II		Gjuhë e Huaj- Anglisht
3	III	I/II		Praktika Mësimore
<b>E – DETYRIME PËRMBYLLËSE. PUNIMI I DIPLOMËS</b>				3% - 5 %

1	III	II		Punimi i diplomës/Provim i përgjithshëm përfundimtar
Totali				

## PROGRAMI I STUDIIT BACHELOR në “PSIKOLOGJI”

Përshkrimi i lëndëve

---

Hyrje në Psikologji  
12/ ECTS

*Hyrje në Psikologji, zhvillohet në vitin e parë , në semestrin e parë dhe të dytë. Gjatë zhvillimit të lëndës synohet që t'iu mundësojmë studentëve të njihen me shkollat psikologjike, të diskutojnë për psikologjinë si shkencë e cila merret me studimin e sjelljes njerëzore në mënyrë sistematike. Studentët do të mund të mësojnë të përshkruajnë se si rritja dhe zhvillimi ndikojnë në personalitetin, kognicionin dhe sjelljen e individit. Gjithashtu studentët do të mund të marrin njohur të përgjithshme mbi disiplinat kryesore të psikologjisë.*

Biologjia dhe proceset  
psikofiziologjike  
12/ ECTS

*“Biologjia dhe proceset psikofiziologjike është lënda që do të zhvillohet në vitin e parë , në programin e studimeve Bachelor në Psikologji. Lënda do të zhvillohet një herë në javë , e ndarë në 3 leksione dhe 1 seminar. Kjo lëndë është e integruar në dy module (A dhe B).*

*Qëllimi i modulit A është marrja e njohurive mbi tematikat kryesore të biologjisë si: ndërtimi i qelizës ,indet, ndërtimi i ADN , ARN dhe ligjet bazë të gjenetikës.Qëllim i modulit B është njohja e studentëve me ndërtimin dhe funksionet e sistemit nervor , njohja me proceset psikobiologjike.njohja me proceset psikobiologjike si: gjumi , kujtesa, emocionet..Studentët në fund të lëndës do të jenë të aftë të shpjegojnë rolin e fiziologjisë dhe ndikimin e saj në manifestimin e sjelljeve.*

### *Psikologji Zhvillimi*

*Psikologjia e Zhvillimit është një lëndë, e cila zhvillohet me studentët e ciklit të parë të studimeve psikologjike. Nëpërmjet saj, studentët marrin njohuri të zgjeruara për zhvillimin e moshës si një proces shumë i rëndësishëm në formimin dhe edukimin e studentit. Gjatë këtij kursi studentët do të thellojnë njohuritë e tyre përsa i përket zhvillimit moshor në aspektin social, psikologjik, emocional, fizik dhe konjitiv.Kjo lëndë diskuton një*

*motorike dhe procese të tjera psikosociale, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, të kuptuarit konceptual dhe moral, identiteti, etj.*

### *Histori e Psikologjisë*

*Lënda 'Histori e Psikologjisë' ka për objekt trajtimi zhvillim dhe rrugëtimin e lindjes dhe rrugëtimin e zhvillimit të historisë së mendimit psikologjik. Ritmet e këtij zhvillimi kanë ecur paralelisht me zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Historia e psikologjisë që nga lindja e saj deri në ditët e sotme ka patur ide të cilat i kanë rezistuar viteve dhe janë pasuruar me kalimin e kohës.*

*rang të gjerë  
temash përfshirë  
këtu: aftësitë*

## *Hyrje në Sociologji*

*Lënda paraqet një hyrje të shkurtër mbi problemet, konceptet dhe termat sociologjik. Trajton shprehitë e tilla si kultura, shoqëria, vlerat, normat, shoqërizimi, ndërveprimi social, etnitetet dhe racat, përkatësia gjinore dhe seksualiteti, feja, ndryshimi social në botën moderne, metodat sociologjike dhe strategjitë e studimit. Sygjeron sesi duhet të sillemi në shoqëri, pse është e rëndësishme të njohim konceptet sociologjike dhe pse na shërbejnë në jetën e përditshme.*

## *Psikologji Sociale*

*Psikologjia Sociale është një program mësimor për studentët e vitit të parë të degës së psikologjisë. Lënda përfshin konceptet dhe teoritë kryesore mbi Psikologjinë Sociale. Psikologjia Sociale synon të plotësojë bazat e dijeve psikologjike që studentet e degës së psikologjisë marrin në modulet e psikologjisë së përgjithshme, psikologjisë së zhvillimit e edukimit. Kjo bëhet nëpërmjet trajtimit të koncepteve bazë të perceptimit të vetes sociale, sjelljes prosociale, atribuimit, agresivitetit si dhe përmes analizës së teorive kyçe të psikologjisë sociale*

## *Gjuhë e Huaj – Anglisht*

*Gjuha Angleze, e cila zhvillohet si lëndë vjetore në vitin e parë dhe të dytë të studimeve. Lënda ka si synim t'u mësojë studentëve se si të lexojnë, punojnë dhe përdorin tekste origjinale në gjuhën angleze. Me anë të teksteve me përmbajtje psikologjike studentët do të zhvillojnë një kuptimësi më të mirë të terminologjive shkencore në fushën e psikologjisë*

## *Hyrje në Psikopatologji dhe Psikodiagnostikim*

*Hyrje në Psikopatologji dhe Psikodiagnostikim, është një lëndë vjetore që zhvillohet në vitin e dytë. Ky është një kurs bazë për Psikopatologjinë e të rriturve. Gjate kursit do të trajtohen tema si: Konceptimet historike mbi Psikopatologjinë, modelet e shpjegimit të sjelljes anormale, kriteret dhe diagnostikimi i crregullimeve të ndryshme si dhe trajtimet e mundshme për secilin crregullim.*

Metodat Kërkimore dhe  
Analiza Cilësore dhe  
Sasiore

*Programi i lëndës: “Metodat e kërkimit dhe analizat sasiore e cilësore në psikologji”, është hartuar për studentët e vitit të dytë të Ciklit të parë Bachelor në “Psikologji . Gjatë zhvillimit të lëndës synohet që t’iu mundësojmë studentëve : Të thellojnë **njohuritë** mbi rëndësinë e procedurave konkrete që ndiqen për të realizuar një kërkim shkencor cilësor.*

Psikologji Personaliteti

*Psikologjia e personalitetit është një program për studentët e vitit të dytë që integron teoritë e personalitetit dhe prek mënyrat e zbatimit të këtyre teorive në fusha e disiplina të ndryshme të psikologjisë. Psikologjia e personalitetit synon që studentët të njohin teoritë kryesore të personalitetit, si dhe t’i aftësojë të diskutojnë mbi këto teori e të jenë kritik. Qëllimi i kësaj lënde është jo vetëm rritja e nivelit të të kuptuarit të tipareve kryesore të personalitetit njerëzor si produkt i bashkëveprimit të faktorëve genetikë me faktorët mjedisorë, por edhe të aftësohen të vlerësojnë tiparet e veta të personalitetit dhe tiparet e të tjerëve*



## *Psikologji e Punës dhe e Organizimit*

*Psikologjia e Punës dhe Organizative është degë e psikologjisë që ka të bëjë me aspekte të ndryshme të njerëzve në punë, duke përfshirë produktivitetin e punonjësve dhe mirëqenien e tyre. Pjesa e “Punës” merret me funksionet e burimeve njerëzore që janë analizimi i punës, vlerësimi i performancës së punonjësit, përzgjedhja, punësimi dhe trajnimi i punonjësve. Pjesa “Organizative” merret me aspektet sociale dhe sociologjike të punës, duke përfshirë qëndrimin e punonjësve, sjelljen, emocionet, shëndetin, motivimin, aftësitë drejtuese, etj.*

## *Psikologji Edukimi dhe Shkollore*

*Psikologjia e edukimit dhe shkollore është një program mësimor për studentët e vitit të dytë të degës së psikologjisë. Kjo lëndë është integrimi i dy moduleve. Psikologjia e Edukimit synon të kuptojë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe rrugët e zhvillimit të këtyre proceseve. Psikologjia Shkollore shpjegon rolin, detyrat dhe çështjet që trajton psikologu shkollor.*

## *Çështje të etikës*

*Çështjet e Etikës synon t'i pajisë studentët me dije të nevojshme dhe të mjaftueshme për sjelljen etike në një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me procesin e këshillimit, por edhe psikoterapisë. Kështu, leksionet eksplorojnë dilemat etike në rrugëtimin e këshilluesve si qenie njerëzore dhe profesionale gjatë punës së tyre. Ky përbën një fakt shumë të vlefshëm e të rëndësishëm duke qenë se në larminë e modeleve teorike dhe praktike ofrojnë rrugëzgjidhje për problematikën e klientëve.*

## *Psikologji Emocioni*

*Psikologji Emocioni' ka për objekt trajtimi emocionalitetin njerëzor, natyrën e tij të veçantë me gjithë rrethin e gjerë të implikimeve në psikologjinë e individit. **Studentë do të përfitojnë** njohuri specifike mbi*

*emocionet,  
inteligjencën  
emocionale si  
çrregullimet e  
gjendjes emocionale.*

*Bazat e Këshillimit  
dhe  
Psikologjia Klinike*

*Lënda paraqet një hyrje të shkurtër mbi shkollat psikologjike që kanë influencuar në procesin e këshillimit. Trajton shprehitë si empatia, komunikimi jo verbal, dëgjimi i vëmendëshëm, sfidimi, komunikimi, nxitëshmëria, menjëhershëmëria, etj. Ju sugjeron ndër të tjera 3 fazat e këshillimit: të cilat janë: Ndihma që Klienti të dallojë situatën e vet problematike dhe mundësitë e pashfrytëzuara; Ndihma që Klienti të përcaktojë se ç'nevoja e dëshira që ka; Ndihma që Klienti të përcaktojë strategjitë për veprim. Në këtë lëndë studentët do të njihen me proceset kryesore të këshillimit si dhe parimet bazë të tij.*

*Teoritë dhe Terapitë e  
Këshillimit në Grup*

*Lënda do të trajtojë teoritë dhe terapitë e këshillimit dhe do të përqëndrohet në të kuptuarin dhe zhvillimin e aftësive*

*për drejtimin e një grupi.  
Do të paraqesë një  
vështrim të përgjithshëm  
mbi llojet e ndryshme të  
grupeve dhe do të  
diskutojë parimet  
kryesore, si edhe elementët  
bazë të procesit të grupit  
dhe praktikës së  
nevojshme, pavarësisht  
llojit të grupit apo qasjes  
teorike të zgjedhur.*

*Psikologji Testimi dhe  
Vlerësimi në Grup*

*Lënda “Testim dhe Vlerësim  
Psikologjik” zhvillohet e ndarë në dy  
module në simestrin e parë dhe të dytë.  
Lënda përmban tema të larmishme  
duke nisur me konceptet bazë të testimit  
dhe vlerësimit psikologjik, historikun e  
vlerësimit dhe testimit psikologjik,  
etikën në testimin dhe vlerësimin  
psikologjik. Përveç kësaj, lënda  
përpiqet të jap njohuri të përgjithshme  
të aplikimeve të testimit dhe vlerësimit  
psikologjik në mjedise nga më të  
larmishme, të tilla si mjediset e  
shëndetit mendor, mjediset klinike, në  
organizata, në mjediset shkollore, në  
mjediset mjekësore dhe ato ligjore.*

*Lënda “Psikologjia Kognitive” është  
një lëndë semestrale dhe me 6 ECTS.  
Lënda ka për qëllim të trajtojë  
konceptet bazë që lidhen me proceset  
me të larta mendore të tilla si:  
paraqitja mendore e njohurive dhe  
simbolikat e saj, imagjinata mendore,*

*Psikologji Konjitive*



